

**AKT THEMELI
MI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“M 7 Sports Wears ” shpk.**

Në Tiranë, sot më datë 18.11.2022, une i poshteshënuari:

EFFIONG EKEMINI EYOH , i datëlindjes 12.07.1996, lindur ne Nigeri, identifikuar me dokument identifikimi: pasaporte me numër A10581255, numer personal 120006228876:

me cilësinë e “ortakeve themelues” deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, “ **M 7 Sports Wears” shpk.**

Neni 1

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**M 7 Sports Wears” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

Shoqëria “**M 7 Sports Wears” shpk** e ka seline në adresë:

“Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit Nr 134, Tirane” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë “**M 7 Sports Wears” shpk** është “Menaxhimi i sportit, ndërmjetësimi dhe konsulenca i cili do të zhvillohet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë këtë fushë”

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1 (një)



kuote e cila zotërohet si më poshtë: EFFIONG EKEMINI EYOH , e datëlindjes 12.07.1996, lindur ne Nigeri,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër A10581255, numer personal 120006228876,zoteron 1(nje) kuote qe perkon me 100% te kapitalit te shoqerise.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit

kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë “M 7 Sports Wears” shpk është: EFFIONG EKEMINI EYOH , i datëlindjes 12.07.1996, lindur ne Nigeri,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër A10581255, numer personal 120006228876.Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë qe eshte data 18.11.2022.

Neni 10

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 11

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare “M 7 Sports Wears” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES:

EFFIONG EKEMINI EYOH



Tiranë, më datë 18.11.2022